



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
REKTORI

Nr. 3423 Prot.

Tiranë, më 13 . 12 .2022

URDHËR I BRENDSHËM

Nr. 30, Datë 07.12.2022

“PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË APLIKIMIT DHE PËRCAKTIMIN E DATËS SË ZHVILLIMIT TË ZGJEDHJEVE PËR ANËTARIN E BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË UT, TË PROPOZUAR NGA STUDENTËT E UT-së”

Në mbështetje të Vendimit nr.782, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë”; të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Tiranës”; të shkresës nr.4673/3, datë 29.09.2022, të MAS; të shkresës nr.322, datë 14.01.2019, të Sekretarit të Përgjithshëm të MASR “Për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.782 datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë”, pas diskutimit edhe në mbledhjen e Rektoratit të UT-së, në mbledhjen datë 15 nëntor 2022,

URDHËROJ:

1. Fillimin e procedurave të aplikimit për anëtarin e Bordit të Administrimit të UT-së, të propozuar nga studentët e Universitetit të Tiranës, nga data 09 -13 janar 2023.
2. Data e zhvillimit të zgjedhjeve për anëtarin e Bordit të Administrimit të UT-së, të propozuar nga studentët e UT-së, të jetë data 2 shkurt 2023.
3. Ngarkohet Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ), dhe Komisionet e Zgjedhjeve në fakultetet/ institutin / filialin e Universitetit të Tiranës, për zbatimin e këtij urdhëri.
4. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. Dr. Artan Hoxha

